



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 25 shtator 2023
Nr.ref.: RK 2271/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI20/23

Parashtrues

N.T.P “Duglas”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev.E.nr.7/2022] të Gjykatës
Supreme të Kosovës të 10 gushtit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga N.T.P “Duglas” me seli në Podujevë (në tekstin e mëtejme: paraashtruesi i kërkesës). Parashtruesin e kërkesës e përfaqësojnë avokatët Lule Bilalli Ymeri dhe Teki Bokshi nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [E.Rev.nr. 7/2022] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 10 gushtit 2022.
3. Aktgjykimi [Rev.E.nr. 7/2022] i Gjykatës Supreme i 10 gushtit 2022, i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 tetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev.E.nr.47/2022] të Gjykatës Supreme të 1 shtatorit 2022, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj) dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenin 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për atë që janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatë

7. Më 1 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 6 shkurt 2023, Kryetarja e Gjykatës, me vendimin [Nr.GJR.KI20/23], caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe me vendimin [Nr.KSH.KI20/23] Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi Peci dhe Enver Peci, anëtarë.
9. Më 20 shkurt 2023, Gjykata : **(i)** njoftoi përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta që të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin e kërkesës, në mënyrë që Gjykata të procedojë tutje me kërkesën; **(ii)** i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe **(iii)** kërkoi nga Gjykata Komerciale në Prishtinë informacione shtesë lidhur me ditën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev.E.nr.7/2022] të 10 gushtit 2022.

10. Më 6 mars 2023, Gjykata pranoi formularin e kërkesës të plotësuar nga përfaqësuesit e parashtruesit të kërkesës ashtu siç u ishte kërkuar.
11. Më 7 prill 2023, Gjykata pranoi fletë-kthesën nga Gjykata Komerciale që dëshmon ditën se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar.
12. Më 30 gusht 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës ta deklarojë kërkesën të papranueshme për shqyrtim.

Përmbledhja e fakteve të rastit

13. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës dhe Komuna e Prishtinës kanë lidhur kontratë [nr. 616-14-091-111] për furnizimin dhe montimin e dollapëve në shkollat fillore të Komunës së Prishtinës. Siç shihet nga dosja e lëndës përfaqësuesi i Komunës së Prishtinës përmes televizionit dhe mediave të shkruara ka paraqitur fakte për cilësinë e punës së kryer të cilat sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës e kanë dëmtuar kompaninë.
14. Më 26 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kundër Komunës së Prishtinës, duke kërkuar nga Gjykata Themelore që:
 - i. Të vërtetohet se ndaj parashtruesit të kërkesës është shkaktuar dëm i pariparueshëm jo material – moral me pasojë cenimin e reputacionit; autoritetit, dinjitetit dhe nderit, duke i shkaktuar vuajtje shpirtërore dhe degraduar para opinionit public nga ana e të paditurës Komuna e Prishtinës në shumën prej 200.000,00 €, me kamatë vonësë 8% të llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë më 26 korrik 2018 deri në ;pagesën përfundimtare;
 - ii. Të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që parashtruesit të kërkesës t’ia kompensojë dëmin jo-material (shumë e cila do të precizohet gjatë shqyrtimit kryesor);
 - iii. Të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që parashtruesit të kërkesës t’ia kompensojë dëmin material për shkak të fitimit të humbur, në lartësinë e cila do të precizohet pas marrjes së ekspertizës përkatëse;
 - iv. Të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që parashtruesit të kërkesës t’ia kompensojë shpenzimet procedurale, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
15. Parashtruesi i kërkesës në padinë e tij kishte konsideruar se deklaratimet në televizion dhe shkrimet në gazeta që ishin dhënë nga përfaqësuesi i Komunës së Prishtinës kanë përmbajtur fakte të pavërteta dhe tendencioze që kishin për qëllim denigrimin dhe cenimin e reputacionit të kompanisë.
16. Më 18 tetor 2018, e paditura Komuna e Prishtinës kishte paraqitur përgjigje në padi, duke pretenduar se “ *...është e vërtetë se pala paditëse nuk i ka respektuar kushtet e kontratës për furnizim me dollap sipas kontratës, ndërsa sipas raportit të Drejtorisë së Arsimit të dt.23.05.2015, gjendja faktike ka ndryshuar me atë që është përcaktuar me kontratë, që do të thotë se dollapët nuk janë prodhuar siç janë paraparë me kontratë, edhe sa i përket kualitetit, edhe materialet nga të cilat janë rregulluar këta dollap, ashtu që nuk i është përmbajtur kushteve të parapara me kontratë”.*
17. Më 16 prill 2020, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [IV.C.nr.416/2018] me të cilin:

- i. E refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës lidhur me detyrimin e të paditurës Komunes së Prishtinës që të bëjë kompensimin në emër të dëmit jo material moral, cenimit të reputacionit, autoritetit, dinjitetit dhe nderit, e po ashtu shkaktimit të vuajtjeve shpirtërore dhe denigrimit para opinionit të gjerë, në shumën prej 200,000.00 €, me kamatë vonese prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë më 26 korrik 2018 e deri në pagesën definitive;
 - ii. E refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte propozuar që të detyrohet e paditura Komuna e Prishtinës që parashtruesit të kërkesës t’ia kompensojë dëmin material-fitimin e humbur në shumën prej 40,303.80 € me kamatë vonese prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me dt.26.07.2018, e deri në pagesën definitive.
18. Gjykata Themelore, në arsyetimin e Aktgjykimit [IV.C.nr.416/2018], ndër të tjerash theksoi :
- “Paditësi nuk ka mundur të argumentoj me prova fajin e palës së paditur lidhur me publikimet e lajmeve nëpër medime televizive dhe të shkruara, nga shkaku se informatat këto medime i kanë marr kryesisht nga drejtorët e shkollave, e jo nga pala e paditur “*
- “Paditësi nuk ka arritur që të provoj faktin se arsye e vetme e mos kontraktimit të punimeve në tender është pikërisht përformanca e dobët që ja kanë publikuar mjetet e informimit lidhur me dollapët e punuar për shkolla fillore në Prishtinë”*
- “Paditësi nuk ja ka prezantuar gjykatës asnjë tender nga i cili është eliminuar, e ku si shkak është dëmi që ju ka bërë nga mjetet e informimit lidhur me punën e dollapëve në shkolla”*
- [...]
19. Brenda afatit ligjor, parashtruesi i kërkesës kishte ushtruar ankesë në Gjykatën Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit [IV.C.nr.436/2018] të Gjykatës Themelore për shkak të : **a)** shkeljes esenciale së dispozitave të procedurës kontestimore; neni 181.1, pika a) e Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK); **b)** vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, neni 181.1, pika b) e LPK-së; **c)** zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, neni 181.1, pika c) e LPK-së; si dhe **d)** vendimit për shpenzimet procedural.
20. Më 5 tetor 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ae.nr.105/2020]:
- i. E refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës; dhe
 - ii. E vërtetoi Aktgjykimin [IV.C.nr.416/2018] të 16 prillit 2020.
21. Në arsyetimin e Aktgjykimit [Ae.nr.105/2020], Gjykata e Apelit kishte aprovuar vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë drejtë zbatoi të drejtën materiale dhe vërtetoi gjendjen faktike. Në rastin konkret, Gjykata e Apelit kishte vlerësuar se “ gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit (...), në këtë rast me dispozitën e nenit 187 par.1 të LMD-së është përcaktuar se “Gjykata i jep shpërblim të drejtë në të holla personit juridik për denigrim të reputacionit ose emrit të mirë, pavarësisht dëmshpërblimit të dëmit material, në rast se gjen se rrethanat e arsyeve të këtyre, qoftë edhe nëse nuk ka dëm material”. Në këtë rast lidhur me shpërblimin e këtij dëmi sipas këtij neni pala paditëse ka dështuar që ta provojë se pala e paditur ia ka paguar të gjitha faturat e parashtruara, përveç faturës me nr.4

për ndalesën prej 10% për të cilën pala paditëse ka ngritur kontest me një padi tjetër me nr.386/15 (...)”.

22. Sa më sipër, Gjykata e Apelit kishte vlerësuar edhe pretendimet e tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën për fitimin e humbur, duke konstatuar se “ ... nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me asnjë prove nuk ka arritur që ta argumentojë lidhjen shkakore ndërmjet veprimeve të së paditurës dhe pasojës respektivisht dëmit të pësuar të paditësit, ndërsa e paditura nuk mund të jetë përgjegjëse për veprimet e të tjerëve edhe nëse paditësit i është shkaktuar dëm”, kurse për pretendimet e tjera kishte konkluduar se aktgjykimi i shkallës së parë përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse.
23. Më 28 janar 2022, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae.nr.105/2020] të 5 tetorit 2021 dhe Aktgjykimit [IV.C.nr.416/2018] të Gjykatës Themelore të 16 prillit 2020, për shkak të : **a)** shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182. paragrafi 2 i LPK-së, posaçërisht pika n) e LPK-së dhe nga neni 182 paragrafi 1 i LPK-së, që është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë; dhe **b)** zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 1 shtator 2022, Gjykata Supreme e Kosovës nëpërmjet Aktgjykimit [Rev.E.nr.7/2022] e refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruar nga parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [Ae.nr.105/2020] të Gjykatës së Apelit të 5 tetorit 2021.
25. Gjykata Supreme e Kosovës, në arsyetimin e Aktgjykimit [E.Rev.nr.47/2022], ndër të tjerash kishte theksuar se :

“Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.”

“Thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 2 p. n) të LPK-së, se dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin për faktet vendimtare, se nuk janë trajtuar pretendimet ankimore, se nuk janë dhënë arsyet e duhura lidhur me kërkesën për kompensimin e dëmi (...), Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike (...) Kështu, edhe kjo Gjykatë, veç të tjerash, konsideron se në rasi konkret juridiko-civil, nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha parakushtet e përgjegjësive për kompensimi e dëmit të parapara me dispozitat e nenit 136, nenit 137 të LMD-së (...) këto parakushte nuk janë provuar së ekzistuari nga pala paditëse.

“Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pa themelta thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale (...) kur kanë gjetur se kërkesëpadija e paditësit për kompensimin e dëmit është e pabazuar, se me provat e administruara nuk janë vërtetuar bindshëm faktet me të cilat do të vërtetohej baza juridike e kërkesëpadiisë për dëmin e kërkuar, nga se në këtë kontekst paditësi nuk ka ofruar prova relevante me të cilat do të vërtetonte bazën dhe ekzistimin e përgjegjësive të së paditurës, sikurse parashihet edhe me dispozitat e nenit 319, nenit 322 të LPK-ë...”

“Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi edhe thëniet e revizionit të paditësit se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore (...), por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së dytë e ka bërë vlerësimin e thënieve të ankesës që kanë qenë me rëndësi vendimtare për marrjen e vendimit të saj në kuptim të dispozitës së nenit 204 të LPK-së (...).”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka nxjerrë Aktgjykimin [Rev.E.nr.7/2022] të 10 gushtit, në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së.
27. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31, parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta “për një vendim të arsyetuar” me pretendimin se: *“Gjykata e Apelit të Kosovës dhe Gjykata Supreme ka për detyrë ligjor e kushtetues që të shqyrtojnë pretendimet ankimore dhe që lidhur me trajtimin e tyre pretendimeve të jep arsyetimin e duhur.”* Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozita ligjore në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, ashtu që të njëjtat kanë shkelur të drejtat e tij themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
28. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46, parashtruesi i kërkesës konsideron se shkelja e të drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, rrjedhimisht ka prodhuar shkelje të së drejtës së tij në mbrojtjen e pronës, e drejtë kjo e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të (i) deklarojë kërkesën e tij të pranueshme dhe (ii) të konstatojë se Aktgjykimi [Rev.E.nr.7/2022] i Gjykatës Supreme i 10 gushtit 2022 nuk është në pajtueshmëri me nenin 31 [E Drejta për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së si dhe nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit shtesë të KEDNj-së.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *“Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*
[...]

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. *“E drejta e pronës është e garantuar.*
2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*
3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.*
4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*
5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.”*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6.1
(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. *“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme”.*
[...]

PROTOKOLLI SHITESË Nr.1 I KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 1

“Mbrojtja e pronës Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk çenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 319

“ 319.1 Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

319.2 Të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit.

319.3 Gjykata vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.”

Neni 321

“321.1 Nuk ka nevojë të provohen faktet e ditura botërisht e as faktet që i ka vërtetuar gjykata në gjykimet e mëhershme.

321.2 Nuk ka nevojë të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor.

321.3 Gjykata ka të drejtë të vlerësojë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, se a do ta merr si të pohuar apo si të kontestuar faktin të cilin pala njëherë e ka pohuar e pastaj tërësisht apo pjesërisht e ka kontestuar, apo e ka kufizuar pohimin duke shtuar fakte tjera.

321.4 Faktet, ekzistimin e të cilave e presupozon ligji, nuk duhet provuar, por mund të provohet mosekzistimi i tyre, po që se me ligj nuk është përcaktuar diç tjetër.”

Neni 222

“Gjykata Supreme e refuzon revizionin si të pathemeltë, me anë të aktgjykimit, po që se konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet e cekura në revizion.”

LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

Neni 136

Bazat e përgjegjësisë

1. “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.
2. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.
3. Për dëmin, pavarësisht nga faji mbahet përgjegjësia edhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.”

Neni 137

Dëmi

“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Për më tepër, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

33. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Rev.E.nr.7/2022] të Gjykatës Supreme të 10 gushtit 2022 dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afat e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
34. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë), përkatësisht me dispozitat (1) (d) dhe (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

(1) “Gjykata mund ta konsideroj një kërkesë të pranueshme, nëse:
[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.

35. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të përmbajë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “*pretendime qartazi të pabazuara*”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; si dhe (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih në këtë kontekst rastet e GjEDNj-së: [Kemmachev kundër Francës](#), Aplikimi nr.17621/91, kategoria (i), [Mentzen kundër Lituanisë](#), Aplikimi nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), Aplikimi nr. 4241/03, kategoria (iii), shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI04/21](#), parashtruese [Nexhmije Makolli](#), Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021 dhe [KI175/20](#), parashtrues [Agjencia Kosovare e Privatizimit](#), Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021).
36. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata do të rikujtojë esencën e çështjes që përmban kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, me ç’rast Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, nen i cili detyron Gjykatën të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
37. Sa më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta në rastin e tij kanë shkelur të drejtën e tij “për një vendim të arsyetuar” të paraparë me nenin [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së (E drejta për një proces të rregulltë), e që për pasojë ka ardhur të shkelja e të drejtave të parapara me nenit 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 (Mbrotjtja e Pronës) të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së.

Pretendimi për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së

38. Lidhur me pretendimin kryesor të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, Gjykata në vazhdim do t’i referohet parimeve të përcaktuara nga GjEDNj, në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe të arsyeshem gjyqësor.

(i) Parimet e përgjithshme për të drejtën për një vendim të arsyetuar

39. Fillimisht, Gjykata rikujton se sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së, veçse ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore e cila është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet: [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr.16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; [Hiro Balani](#)

[kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; [Higgins dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 134/1996/753/952 Aktgjykim i 19 shkurtit 1998; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr.30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999,; [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr.49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; [Suominen kundër Finlandës](#), nr.37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; [Buzescu kundër Rumanisë](#), nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; [Pronina kundër Ukrainës](#), nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe [Tatishvili kundër Ruisë](#), nr. 1509/02 Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet [KI22/16](#), parashtrues [Naser Husaj](#), Aktgjykim i 9 qershorit 2017; [KI97/16](#), parashtrues [IKK Classic](#), Aktgjykim i 9 janarit 2018; [KI143/16](#), parashtrues [Muharrem Blaku dhe të tjerët](#), Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; [KI87/18](#), parashtrues [IF Skadiforsikring](#), Aktgjykim i 27 shkurtit 2019; [KI35/18](#), parashtrues [Bayerische Versicherungsverband](#), Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues [Albert Rakipi](#), Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

40. Në këtë drejtim, garancitë e përcaktuara në nenin 6 paragrafi 1 përfshijnë edhe detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GjEDNj-së, [H. Kundër Belgjikës](#), nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar u ofron siguri palëve se çështja e tyre është dëgjuar dhe trajtuar me të vërtetë.
41. Megjithatë, edhe pse gjykatat e brendshme kanë lirinë e caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e tyre, të njëjtat janë të detyruara të arsyetojnë dhe justifikojnë të gjitha veprimet e tyre duke përfshirë edhe vendimet që kanë ardhur si rrjedhojë e këtyre veprimeve (shih rastet e GjEDNj-së: [Suominen kundër Finlandës](#), nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe Aktgjykimin [Carmel Saliba kundër Maltës](#), nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
42. Në këtë drejtim, gjykata më e ulët apo autoriteti shtetëror nga ana tjetër, duhet të japin arsye dhe arsyeime të tilla të cilat do t'u mundësojnë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GjEDNj-së, [Hirvisaari kundër Finlandës](#), nr. 49684/99, Aktgjykim i 25 dhjetorit 2001, paragrafi 30).
43. Nga neni 6 paragrafi 1 i KEDNj-së, rrjedh detyrimi për gjykatat që të japin arsyetimin e duhur për vendimet e tyre, por kjo nuk krijon obligim për këto gjykata që të ofrojnë përgjigje të detajuara lidhur me secilin argument (shih rastet e GjEDNj-së: [Van de Hurk kundër Holandës](#), nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994, paragrafi 61; [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykim i 29 janarit 1990, paragrafi 26; [Perez kundër Francës](#), nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
44. Detyrimi i gjykatës lidhur me arsyetimin e vendimit të saj, është e ndërlidhur ngushtë me natyrën e vendimit që kjo e fundit e merr dhe kjo mund të determinohet varësisht nga rrethanat konkrete të rastit në fjalë, por është e nevojshme të merren parasysh, ndër të tjera, llojet e ndryshme të parashtrësive që një palë mund t'i paraqesë gjykatës, si dhe dallimet që ekzistojnë ndërmjet sistemeve juridike të vendeve në lidhje me dispozitat ligjore, rregullat zakonore, pozicionet juridike dhe paraqitjen e hartimit e aktgjykimeve (shih rastet e GjEDNj-së: [Ruiz Torija kundër Spanjës](#), nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; [Hiro Balani kundër Spanjës](#), nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27).
45. Në këtë kuptim, gjykatat janë të obliguara që:

- a) të shqyrtojnë argumentet kryesore të palëve (shih rastet e GjEDNj-së: [Buzescu kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 24 gushtit 2005, nr. 61302/00, paragrafi 67; dhe [Donadze kundër Gjeorgjisë](#), nr. 74644/01, Aktgjykim i 7 qershorit 2006, paragrafi 35);
- b) të shqyrtohen me shumë rigozitet dhe kujdes të veçantë kërkesat në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, KEDNj dhe Protokollat e saj (shih rastet e GjEDNj-se: [Fabris kundër Francës](#), nr.16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013, paragrafi 72; [Eagner dhe JMËL kundër Luksemburgut](#), nr. 76240/01, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96).
46. Gjykata rikujton se neni 6 paragrafi 1 nuk i detyron gjykatat e rregullta që të japin një arsyetim më të detajuar kur ato thjesht zbaton një dispozitë të caktuar ligjore lidhur me bazën ligjore për refuzimin e ankesës, sepse ajo ankesë nuk ka një perspektivë për sukses (shih rastet e GjEDNj-së: [Burg dhe të tjerët kundër Francës](#), nr. 34763/02, Vendim i 28 janarit 2003; dhe [Gorou kundër Greqisë \(nr.2\)](#), nr. 12686/03, Vendim i 20 marsit 2009, paragrafi 41).
47. Prandaj, në një rast ku bëhet fjalë që të lejohet parashtrimi i ankesës, që është një parakusht për procedurën të një gjykate më të lartë, si dhe për një vendim të mundshëm, neni 6, paragrafi 1, nuk mund të interpretohet në atë kuptim që të urdhëron një arsyetim të detajuar të vendimit për refuzimin e kërkesës për parashtrimin e ankesës (shih rastet e GjEDNj-së, [Kukkonen kundër Finlandës \(nr.2\)](#), nr. 47628/06, Aktgjykim i 13 prillit 2009,) paragrafi 24; [Bufferne kundër Francës](#), nr. 54367/00, Vendim i 26 shkurtit 2002).
48. Përveç veç kësaj, kur refuzon një ankesë, Gjykata e Apelit, në parim, thjesht mund të pranojë arsyetimin e vendimit të dhënë nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), të cituar më lart, paragrafi 26; shih, në kundërshtim me këtë, [Tatishvili kundër Ruisisë](#), nr. 1509/02, Aktgjykim i 9 korrikut 2007, paragrafi 62). Megjithatë, koncepti i procedurës së drejtë nënkupton që gjykata vendase që ka dhënë një shpjegim të ngushtë për vendimet e saj, qoftë duke përsëritur arsyetimet e dhëna më parë nga një gjykatë më e ulët ose në ndonjë mënyrë tjetër, në fakt është marrë me çështje të rëndësishme brenda juridiksionit të saj, që do të thotë se nuk i pranoi thjesht dhe pa përpjekje shtesë konkluzionet e arritura nga gjykata më e ulët (shih rastin e GjEDNj-së: [Helle kundër Finlandës](#), nr. (157/1996/776/977), Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Kjo kërkesë është aq më tepër e rëndësishme nëse pala në kontest nuk ka pasur mundësi t'i paraqesë argumentet e saj gojarisht në procedurën para gjykatës vendase.
49. Megjithatë, gjykatat e shkallës së dytë të cilat kanë juridiksion për të hedhur poshtë ankesat e pabazuara dhe për të zgjidhur çështjet faktike dhe juridike në procedurën kontestimore, janë të obliguara të arsyetojnë se përse refuzuan të vendosin për ankesën (shih rastin e GjEDNj-së, [Hansen kundër Norvegjisë](#), nr. 15319/09, Aktgjykim i 2 janarit 2015, paragrafët 77-83).
50. Për më tepër, GjEDNj nuk përcaktoi se ishte shkelur e drejta në një rast në të cilin nuk është dhënë një sqarim specifik në lidhje me një pohim që i referohej një aspekti të parëndësishëm të rastit, përkatësisht mungesës së nënshkrimit dhe vulës, që është një gabim i një natyre më shumë formale sesa materiale dhe ai gabim u korrigjua menjëherë (shih rastin e GjEDNj-së, [Mugoša kundër Malit të Zi](#), nr. 76522/12, Aktgjykim i 21 shtatorit 2016, paragrafi 63).

(ii) Aplikimi i parimeve të përgjithshme për të drejtën për një vendim të arsyetuar në rrethanat e rastit konkret

51. Duke iu rikthyer rastit konkret dhe duke parë shpjegimin e aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme në kuadër të vendimeve të paarsyetueshme gjyqësore, Gjykata konstaton se bazë për shkeljet e pretenduara është fakti se gjykatat nuk i kanë shqyrtuar dhe arsyetuar në mënyrë adekuate pretendimet që ai i konsideron të rëndësishme. Megjithatë, Gjykata nuk gjen në kërkesë në mënyrë specifike se cilat pretendime parashtruesi i kërkesës konsideron se nuk janë shpjeguar si duhet nga gjykatat e rregullta. Ajo që Gjykata vëren në kërkesë është fakti se parashtruesi, në përpjekje për të shpjeguar shkeljen e pretenduar, citon praktikën e GJEDNJ-së, duke mos u munduar të tregojë në mënyrë të qartë dhe konkrete se cilat janë pretendimet, të cilat gjykatat e rregullta nuk ka shpjeguar në mënyrë adekuate në procedurë, duke marrë parasysh bazueshmërinë e kërkesës së tij.

52. Më konkretisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e shpjegon shkeljen e pretenduar si më poshtë:

“Gjykata e Apelit e Kosovës dhe Gjykata Supreme e Kosovës ka për detyrim ligjor dhe kushtetues që të i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe që lidhur me trajtimin e atyre pretendimeve të jep arsyetim të duhur. Në këtë çështje Gjykata e Apelit e as Gjykata Supreme e Kosovës nuk ka shqyrtuar pretendimet ankimore kryesore dhe lidhur me ato pretendime nuk është sqaruar. Nuk mjafton se pretendimet nuk janë të pabazuara por duhet të ipen arsyeime konkrete, faktike dhe juridike pse ato nuk qenkan të bazuara. Vetëm parafrazimi i dispozitës ligjore nuk është arsyetim”.

53. Prandaj, nga pjesa e cituar e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është më se e qartë se parashtruesi konsideron se gjykatat nuk kanë dhënë arsye konkrete dhe ligjore pse kërkesëpadia e tij ishte e pabazuar.

54. Rrjedhimisht, Gjykata do të shikojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Supreme në kontekstin e arsyeve pse kërkesëpadia e parashtruesit është e pabazuar, si dhe nëse Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme kanë shpjeguar në mënyrë mjaftueshëm të vlefshme arsyet që çuan në përfundimin se kërkesëpadia është e pabazuar, dh nëse i plotëson kriteret e një vendimi të arsyetuar gjyqësor.

55. Prandaj, sa i përket aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, duke shqyrtuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në kontekstin e arsyeve për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit, arriti në përfundimin se arsyeja e refuzimit të saj ishte se, në bazë të nenit 187 par. 1. të LPK-së, paditësi nuk ka vërtetuar se i padituri e ka dëmtuar paditësin me veprimet apo mosveprimet e tij për shkak se i padituri ka paguar të gjitha faturat e dorëzuara [...] ndërsa për publikimin e informacionit në mjetet e informimit publik, Gjykata e Apelit, arriti në përfundimin se *“për politikën editoriale dhe publikimin e çdo mjeti informimi ekziston e ashtuquajtura përgjegjësi kaskaduese, por kjo përgjegjësi nuk bie mbi të paditurin”.*

56. Përveç kësaj, Gjykata e Apelit arsyetoi se kur i dëmtuari ka të drejtën e kompensimit të dëmit si dhe përfitimeve të humbura në përputhje me dispozitën e nenit 173, paragrafi 1 i LMD-së, por që nga shkresat e lëndës dhe kërkesëpadia rrjedh se paditësi, pa prova, nuk ka arritur të argumentojë lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të të paditurit dhe pasojave, pra dëmit të pësuar nga paditësi, ndërsa i padituri nuk mund të mbajë përgjegjësi për veprimet e të tjerëve edhe nëse paditësi dëmtohet.

57. Rrjedhimisht, është më se e qartë se Gjykata e Apelit ka shqyrtuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë dhe ka dhënë një shpjegim se pse kërkesa për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial nuk mund të realizohet, duke konstatuar se nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me dispozitat ligjore të lartpërmendura..
58. Për më tepër, nga shpjegimi i vendimit të Gjykatës së Apelit, Gjykata konstaton se ka marrë parasysh edhe arsyet e tjera që parashtruesi i ka cekur në kërkesëpadi, por që pas analizës i ka hedhur poshtë si të pabazuara në përputhje me nenin 319, para. 1 të LPK-së, duke arsyetuar se në rastin konkret paditësi nuk ka mundur të sigurojë asnjë provë që mund të vërtetojë pretendimet e tij.
59. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se Gjykata e Apelit nuk ka dhënë arsye konkrete dhe ligjore në aktgjykim se pse kërkesëpadija e ti, ishte e pabazuar.
60. Për më tepër, duke marrë në konsiderat edhe vendimin e Gjykatës Supreme në kontekstin e pretendimeve të parashtruesit, Gjykata nuk mund të mos vërejë se parashtruesi i ngriti të njëjtën natyrë të shkeljeve të pretenduara para kësaj gjykate, ndërkohë që konsideron se vendimi i Gjykata e Apelit është në kundërtënie me arsyetimin e fakteve vendimtare dhe se nuk janë dhënë shpjegimet përkatëse lidhur me kërkesën për dëmshpërblim. Ishte Gjykata Supreme ajo që, duke vlerësuar pretendimet e parashtruesit, arriti në përfundimin se:

“[...] aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante (...). Kështu, edhe kjo Gjykatë, veç të tjerash, konsideron se në rastin konkret juridiko-civil, nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha parakushtet e përgjegjësive për kompensimin e dëmit të parapra me dispozitat e nenit 136, nenit 137 të LMD-së, siç janë: ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies së detyrimit dhe të përgjegjësive për dëmin e shkaktuar, pra, shkaktuesin e dëmit dhe të dëmtuarin, ekzistimi i faktit dëmtues, nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, ekzistimi i lidhjes shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit [...]”

61. Për më tepër, për Gjykatën është më se evidente se Gjykata Supreme është marrë edhe me çështje të shkeljes së të drejtave materiale nga gjykatat më të ulëta, duke konstatuar se gjykatat kanë vlerësuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale kur kanë konstatuar se kërkesëpadija e paditësit për dëmshpërblim ishte e pabazuar, sepse provat nuk vërtetonin bindshëm faktet që do të vërtetonin bazën juridike të kërkesëpadisë për dëmin e kërkuar, sepse në këtë kontekst paditësi nuk ka ofruar provat përkatëse për të vërtetuar bazën dhe ekzistencën e përgjegjësive së paditurit, siç parashikohet me dispozitat. të nenit 319, nenit 322 të LPK-së [...].”
62. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Gjykata Supreme është përgjigjur në të gjitha pretendimet që i ka ngritur në kërkesën për revizion duke dhënë arsye të hollësishme për të gjitha çështjet e ngritura.
63. Prandaj, Gjykata vlerëson se aktgjykimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, ishin mjaftueshëm të arsyetuara dhe i plotësojnë kriteret e vendimit të arsyetuar gjyqësor, të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së. Për më tepër, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta i kanë trajtuar me kujdes pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe kanë arsyetuar mjaftueshëm për sa i përket të drejtës së tij në kompensim dëmi dhe fitimin e humbur, siç pretendon parashtruesi i kërkesës në rastin e tij.

64. Sa më sipër, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të provojë dhe të bindë gjykatat e rregullta se Komuna e Prishtinës si palë e paditur e ka dëmtuar nga veprimet e saja. Nga shkresat e lëndës dhe rrjedha e procedurës, qartazi vërehet se të tri instancat e gjykatave të rregullta kanë pasur qëndrimin e njëjtë juridik sa i përket vlerësimin të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke sqaruar hollësisht mosbesimin e dhënë ndaj ekspertizës financiare dhe arsyet për refuzimin e kërkesëpadisë dhe mjeteve të tjera të rregullta juridike të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës.
65. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se në lidhje me vlerësimin e pretendimeve “të shkallës së katërt” e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, ajo vazhdimisht ka theksuar se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Ky koncept, kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton: (i) mundësinë e zhvillimit të procedurave sipas parimit të kontradiktoritetit; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të kësaj procedure, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrën e duhur; dhe për pasojë, procedura, marrë në tërësi, do të rezultonte si e drejtë. Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë në një procedurë në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr.10588/83, 10589/83, 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës [KI128/19](#), Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 58; dhe [KI22/19](#), parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42.)
66. Bazuar në këtë, Gjykata vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e gjykatave të rregullta. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk është pajtuar me arsyetimet e gjykatave të rregullta dhe me rezultatin e tyre. Por, ky mospajtim, nuk mund t'i shërbejë parashtruesës së kërkesës si e drejtë që të parashtrojë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (shih rastin e GjEDNj-së: [Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21; si dhe rastin e Gjykatës [KI125/11](#), *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
67. Nga elaborimi i mësipërm, Gjykata konstaton se Gjykata Supreme, si instanca e fundit nga gjykatat e rregullta, ka respektuar kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor dhe vlerëson se nuk ekziston ndonjë rrethanë që tregon se Gjykata Supreme ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar, aplikim i të cilit do të mund të rezultonte në konkluzione arbitrare apo qartazi të paarsyeshme për parashtruesin e kërkesës. Rrjedhimisht, pretendimet e parashtruesit të kërkesës i përkasin kategorisë së parë (i) si “shkalla e katërt”, prandaj, të njëjta konsiderohen se janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht janë të papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullorës së punës.

Pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së

68. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij kishte konkluduar se si pasojë e shkeljes së drejtës së tij për “vendim të arsyetuar gjyqësor”, i janë shkelur edhe të drejtat e

garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GjEDNj-së, Gjykata e shpallë kërkesën e papranueshme si qartazi të pabazuar me kriterin (iii) e pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara” edhe në rastet kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike si në vijim:

- a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih rastet e GjEDNj-së: [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, Vendim i 31 majit 2005 dhe [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, Vendim i 25 shtatorit 2008);
- b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin e Gjykatës, [KI166/20](#), parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

69. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjesht pretendon shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, por ai nuk arsyeton, përkatësisht nuk shpjegon fare se si në rastin e tij ka ardhur deri te shkelja e këtyre të drejtave. Prandaj, Gjykata konstaton se përkritazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtave të garantuara me nenet e lartcekura, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) pretendime të kategorizuara si “të pambështetura ose të paarsyetuara”, sepse parashtruesi i kërkesës thjesht kishte cituar dispozitën e Kushtetutës, pa shpjeguar se si është shkelur.

Përfundimi

70. Si përmbledhje, Gjykata duke i marrë parasysh elaborimin dhe konstatimin e mësipërm, vlerëson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së i përkasin kategorisë së parë(i) pretendime të kategorizuara si “të shkallës së katërt”; dhe si të tilla do të konsiderohen pretendime si qartazi të pabazuara, bazuar në Kushtetutë dhe në dakordim të rregullit 34 (2) të Rregullorës së Punës.
71. Ndërsa, Gjykata, duke marrë në konsideratë elaborimin e mësipërm në konkluzion si dhe pretendimet për shkelje të neneve 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit Shtesë Nr.1 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë (iii) nënkategorisë (a), të pretendimeve “të pambështetura ose të paarsyetuara”; dhe si të tilla do të konsiderohen pretendime si qartazi të pabazuara, bazuar në Kushtetutë dhe në dakordim të rregullit 34 (2) të Rregullorës së Punës.
72. Përfundimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit të kërkesës në tërësinë e saj, shpallet qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht e papranueshme në pajtueshmëri me rregullin 34(2) të Rregullorës së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 34 (2) dhe 48 (2) të Rregullorës së punës, në seancën e mbajtur më 30 gusht 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani